

20 VJET AMF – KOHA PËR NJË ETAPË TË RE DREJT SHQPËRISË EVROPIANE 2030



Stafi i AMF-së gjatë workshop-it të zhvilluar në kuadër të 20-vjetorit të institucionit.



PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN, JO VETËM SFIDË, POR MUNDËSI PËR TË NDËRTUAR INSTITUCIONE MË TË FORTA DHE MË PROFESIONALE”

Adela Xhemali

Drejtoreshë e Përgjithshme Ekzekutive AMF

Në 20-vjetorin e krijimit, Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare e nisi vitin 2026 si një etapë të rëndësishme në rrugëtimin drejt vizionit Shqipëria 2030. Në workshop-in e zhvilluar me drejtuesit dhe stafin, AMF e lidhi fazën e ardhshme të zhvillimit të saj me integrimin evropian, modernizimin rregullator dhe forcimin e rolit të institucionit në mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare.

Përvjetori u trajtua jo thjesht si moment reflektimi, por si një mundësi për të kthyer përvojën e dy dekadave në kapacitete më të avancuara institucionale dhe mbikëqyrëse.

Në hapje të workshop-it, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive, znj. Adela Xhemali, theksoi se viti 2026 përbën një moment të rëndësishëm për AMF-në, në funksion të modernizimit institucional, përsheptimit të përafrimit rregullator me Bashkimin Evropian dhe konsolidimit të një vizioni afatgjatë në përputhje me Shqipëria 2030. Ajo nënvizoi se procesi i integritimit evropian duhet parë jo vetëm si një sfidë, por si një mundësi konkrete për të ndërtuar institucione më të forta, më profesionale dhe më të orientuara drejt së ardhmes.

> Lexo më shumë...

VËSHTRIM HISTORIK I TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE

2006

7 SHOQËRI SIGURIMI JO-JETË

2 SHOQËRI SIGURIMI JETË

1 SHOQËRI SIGURIMI JETË & JO-JETË

3 SHOQËRI PENSIONESH PRIVATE

Tregu i investimeve i përqëndruar në tituj borxhi të qeverisë

Tregu i aksioneve i pazhvilluar

2026

8 SHOQËRI SIGURIMI JO-JETË

5 SHOQËRI SIGURIMI JETË

4 Shoqëri Administruese të **Fondeve të Pensionit Privat** (7 fonde pensioni)

6 Shoqëri Administruese të **Fondeve të Investimit Kolektiv** (15 fonde investimi)

Obligacione me ofertë publike të emërtuara në 2023

NË FOKUS:

- Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së në Forumin Rajonal Euromoney në Vienë
- Vështrim mbi tregjet nën mbikëqyrje
- AMF dhe Banka Botërore forcojnë partneritetin për reformat rregullatore
- Drejtoresha Ekzekutive e AMF-së, znj. Adela Xhemali, takim me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko,
- AMF afron të rinjtë me bursën dhe tregun e kapitaleve
- AMF prezanton vizionin dhe reformat drejt standardeve të BE-së
- EIOPA 2030 – Një vizion me fokus qëndrueshmërinë dhe digitalizimin

DREJTUESJA E AMF-SË NË FORUMIN RAJONAL EUROMONEY NË VIENË



Drejtoresha Ekzekutive e Autoritetit Shqiptar të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Zonja Adela Xhemali, mori pjesë si paneliste në forumin rajonal Euro-money në 13-14 Janar në Vjenë, ku diskutoi mbi progresin e Shqipërisë në përshtatjen e sektorit financiar jo-bankar me standardet e Bashkimit Evropian, në tryezën e rrumbullakët "Anëtarësimi i Shqipërisë në BE: A është gati sistemi financiar?".

> Lexo më shumë...

DREJTORESHA E AMF-SË TAKIM ME DREJTUESIT E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT



Mbikëqyrja dhe zhvillimi i tregut të sigurimeve dhe veçanërisht përafrimi me standardet e Bashkimit Evropian, ishin qendra e bisedës mes Drejtoreshës Ekzekutive të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Znj. Adela Xhemali, me drejtuesit e shoqërive të sigurimit që operojnë në Shqipëri. Takimi u zhvillua në një moment të rëndësishëm për institucionin, të shënuar nga nisja e një kapitulli të ri drejtimi dhe sfidat e integritimit evropian.

> Lexo më shumë...

DREJTORESHA E AMF TAKIM ME PËRFAQËSUES TË GIZ



Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Znj. Adela Xhemali, zhvilloi një takim me përfaqësues të projektit GIZ SANECA, kryesuar nga znj. Blerina Raca menaxhere e projektit, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe mbështetjes për zhvillimin e tregjeve financiare në Shqipëri. Takimi u zhvillua në funksion të përmbushjes së angazhimeve që rrjedhin nga Kapitulli 9 i procesit të integritimit evropian i kryesuar nga AMF, me fokus harmonizimin e legjislacionit kombëtar me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian.

> Lexo më shumë...

AMF BASHKËPUNIM ME DEPARTAMENTIN AMERIKAN TË THESARIT



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) po bashkëpunon ngushtësisht me ekspertët e Departamentit Amerikan të Thesarit përmes zyrës së tij të asistencës teknike (OTA), për forcimin e tregjeve financiare jo-bankare, i shtrirë në disa fusha kyçe, përfshirë teknologjinë e informacionit, tregun e sigurimeve, mbrojtjen konsumatore, edukimin financiar dhe veçanërisht zhvillimin e tregut të kapitaleve në Shqipëri.

> Lexo më shumë...

DREJTORESHA EKZEKUTIVE E AMF-SË, ZNJ. ADELA XHEMALI, TAKIM ME GUVERNATORIN E BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. GENT SEJKO

Drejtoresha Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), znj. Adela Xhemali, zhvilloi një takim zyrtar me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko. Gjatë takimit, Guvernatori Sejko e uroi znj. Xhemali për detyrën e re në krye të një institucioni me rol kyç për zhvillimin dhe stabilitetin e mëtejshëm të sistemit financiar.

Gjatë takimit, znj. Xhemali theksoi se bashkëpunimi i strukturuar dhe i qëndrueshëm ndërinstitucional përbën një element kyç për garantimin e stabilitetit financiar, veçanërisht në kushtet e rritjes së ndërveprimit ndërmjet sektorit bankar dhe atij jobankar. Gjithashtu u theksua rëndësia e ndërtimit të një kuadri të qartë bashkëpunimi për mbikëqyrjen e grupeve financiare dhe konglomerateve financiare, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, përmes koordinimit ndërinstitucional.

Znj. Xhemali theksoi gjithashtu se procesi i integritimit evropian kërkon një angazhim të vazhdueshëm dhe të koordinuar ndërmjet dy rregullatorëve, veçanërisht në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga negociatat për kapitujt përkatës të acquis communautaire, ku AMF dhe Banka e Shqipërisë luajnë role kyçe.

> Lexo më shumë...





AMF PREZANTON VIZIONIN DHE REFORMAT DREJT STANDARDEVE TË BE-SË NË TAKIM ME KOMISIONIN PËR EKONOMINË, PUNËSIMIN DHE FINANCAT

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) priti sot një përfaqësi të Komisionit për Ekonominë Punësimin dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, të kryesuar nga znj. Milva Ekonomi, në një takim informues mbi zhvillimet kryesore në tregjet financiare jo-bankare dhe progresin e AMF-së në përafrimin e kuadrit ligjor me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

> Lexo më shumë...



DREJTORESHA E PËRGJITHSHME E AMF-SË ADELA XHEMALI TAKIM ME SHOQATËN E SIGURIMIT TË JETËS, PENSIONEVË DHE FONDEVE TË INVESTIMIT

Në një moment kur agjenda e integritimit evropian po e orienton sektorin financiar jobankar drejt kërkesave më të larta për standarde, menaxhim të riskut dhe mbrojtje të konsumatorit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) po zhvillon takime me përfaqësues të tregjeve nën mbikëqyrje për bashkëpunim në përafrimin e kuadrit rregullator me standardet e Bashkimit Evropian.

> Lexo më shumë...

REFORMAT PRIORITARE DREJT BE-SË, ZNJ.ADELA XHEMALI TAKIM ME PËRFAQËSUES TË LARTË TË BANKËS BOTËRORE



Reformat në tregjet financiare dhe mbështetja për procesin e integritimit në Bashkimin Evropian ishin në fokus të një takimi mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe ekspertëve të Bankës Botërore, në kuadër të misionit për përgatitjen e një programi Financimi për Politikën e Zhvillimit (DPF).

> Lexo më shumë...

AMF NË BASHKËPUNIM ME BANKËN BOTËRORE DHE EKSPERTËT ZVICERANË PËRMBYLL ME SUKSES STUDIMIN E IMPAKTIT SASIOR SIPAS SOLVENCY II



Në vijim të Projektit “Për Qëndrueshmërinë dhe Zhvillimin Financiar të Shqipërisë,” i cili mbështetet nga Banka Botërore financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Cështjet Ekonomike (SECO) nën Programin F4D, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare priti ekspertët e lartë të “Prime Re Solution” kompani prestigjioze zviceriane në fushën aktuaristike, në lidhje me zbatimin e Solvency II.

> Lexo më shumë...

PËR HERË TË PARË AMF ORGANIZON TRYEZË GJITHËPËRFSHIRËSE KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR NISMAT LIGJORE NË KUADËR TË INTEGRIMIT EVROPIAN



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi për herë parë një tryezë të gjerë diskutimi me grupet e interesit për 3 projektligje që lidhen me Kapitullin 6 “Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare” të Acquis të Bashkimit Evropian. Tryeza zhvillohet në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Shoqatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, GIZ.

> Lexo më shumë...

AMF TRAJNIME TË AVANCUARA PËR STAFIN DHE PËR STRUKTURAT E SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE PËR SOLVENCY II, ME MBËSHTETJEN E SECO DHE BANKËS BOTËRORE



Në një moment të rëndësishëm për zhvillimin e tregut të sigurimeve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ka thelluar programin e trajnimeve për stafin e tij dhe për shoqëritë e sigurimit, lidhur me Solvency II.

> Lexo më shumë...

AMF AFRON TË RINJTË ME BURSËN DHE TREGUN E KAPITALEVE

ÇFARË OFROI KY EDICION?



Në një ceremoni ku energjia e konkurrencës mes studentëve u ndërthur me gjuhën e riskut dhe strategjisë, u përmbyll edicioni i pestë i konkursit "Të mësojmë për bursën" – Stock Market Learning Competition, një nismë e mbështetur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në bashkëpunim me German Sparkassenstiftung Albania.

> Lexo më shumë...

STUDENTË DHE NXËNËS
PJESËMARRËS



111

+20




UNIVERSITETE DHE
SHKOLLA TË MESME
TË PËRFSHIRA

JAVË SIMULIM
INVESTIMESH VIRTUALE
NË BURSË



6



AMF NXJERR PËR KONSULTIM PUBLIK PROJEKTLIGJIN "PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 236, DATË 18.2.2010 "PËR MARRJEN NË KONTROLL TË SHOQËRIVE ME OFERTË PUBLIKE" DHE PROJEKTLIGJIN "PËR KËRKESAT E TRANSPARENCËS PËR EMETUESIT E TITUJVE".

> Lexo më shumë...


AMF DHE BANKA BOTËRORE FORCOJNË PARTNERITETIN PËR REFORMAT RREGULLATORE FINANCIARE TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Partneriteti për integrimin evropian dhe mbështetja për modernizimin e mbikëqyrjes financiare ishin në fokus të takimit mes Drejtoreshës së Përgjithshme Ekzekutive të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) Adela Xhemali dhe Menaxherit të ri të Bankës Botërore për Shqipërinë, z. Massimiliano Paolucci.



> Lexo më shumë...

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË PRIMIN E SIGURIMIT



> Lexo më shumë...

Fjala e muajit

Finfluencer

Finfluencer i referohet një krijuesi përmbajtjeje (contentcreator) që përdor rrjete sociale dhe kanale digjitale për të ndikuar në sjelljen financiare dhe vendimet e investimit të investorëve potencialë, duke postuar për lloje të ndryshme asetesh, nga kriptomonedhat te aksionet, si edhe për financat personale.



Këshillat e tyre ndonjëse tingullojnë të besueshme, shpesh **mungojnë ekspertizën e duhur**, gjë që mund të çojë në **investime të rrezikshme** dhe **potencialisht në mashtrime**.



SI FUNKSIONON PROCESI I ANKIMIMIT?

Nëse keni një mosmarrëveshje me një shoqëri sigurimi, si p.sh. vonesa në trajtimin e dëmit, mospajtim mbi vlerësimin e dëmit, mosrespektim i kushteve të kontratës, ju keni të drejtë të kërkonti sqarim dhe zgjidhje të çështjes përmes paraqitjes së një ankese.

HAPI 1: PARAQITJA E ANKESËS PRANË SHOQËRISË SË SIGURIMIT

Hapi i parë që duhet të ndiqni është gjithmonë paraqitja e një ankese tek shoqëria e sigurimit përkatëse, pasi në këtë mënyrë i jepni mundësinë të rishikojë rastin dhe të japin një përgjigje zyrtare brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e ankësës tuaj. Nëse shoqëria e zgjidh çështjen, procesi përfundon këtu. Nëse nuk merrni përgjigje, ose përgjigja e shoqërisë nuk e zgjidh problemin, mund të kaloni në hapin e dytë.

HAPI 2: PARAQITJA E ANKESËS PRANË AMF

Nëse ankesa nuk merr zgjidhje në hapin e parë, mund ta eskaloni çështjen pranë AMF në një prej 3 mënyrave të mëposhtme:

- Me postë fizike në zyrën e protokollit të AMF,
- Me postë elektronike në adresën konsumatori@amf.gov.al,
- Online nëpërmjet faqes zyrtare të AMF-së.

ÇFARË TË PËRFSHINI NË ANKESËN PËR AMF?

Për të qenë e plotë dhe anashkaluar vonesa në plotësimin e dokumentacionit, ankesa duhet të shoqërohet me:

- të dhënat tuaja (emër, kontakt) dhe emrin e shoqërisë së sigurimit;
- përshkrimin e çështjes;
- kopjen e ankësës që keni dërguar te shoqëria dhe përgjigjen e saj (ose provë që nuk ka përgjigje);
- çdo dokument tjetër që vërteton pretendimin tuaj.

AMF më pas e shqyrton ankësën dhe kërkon sqarime/dokumente nga shoqëria, por në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet pas trajtimit nga shoqëria dhe pas shqyrtimit nga AMF, mosmarrëveshja mund të ndiqet më tej me rrugët ligjore të parashikuara.

TREGU I SIGURIMEVE NË JANAR-SHKURT 2026

Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Shkurt 2026 shënuan rritje të qëndrueshme, me primet e shkruara bruto që arritën në 3,927 milionë lekë, duke u rritur me 3.07% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Numri i kontratave të lidhura u rrit lehtë në 228,358, me një rritje prej 0.22%.


Sigurimet Jo-Jetë dominojnë tregun dhe përbëjnë 90.75% të vëllimit të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës zënë 9.25%. Nga ana tjetër, sigurimi i detyrueshëm përbën 60.62%, ndërsa vullnetari 39.38%.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik arritën 2,381 milionë lekë, me një rritje prej 3.77%, ku produkti MTPL e brendshme shënoi rritje të ndjeshme në volum dhe numër kontratash. Sigurimet vullnetare patën rritje prej 2%, me portofolin e Jo-Jetës që kontribuon më së shumti, veçanërisht në sigurimet nga zjarri dhe forcat e natyrës.

Sigurimet nga aksidentet dhe shëndeti shënuan rritje prej 3.24%. Sigurimet e Jetës vazhduan rritjen e butë, me primet që arritën në 363 milionë lekë, ose 1.13%.

Dëmet e paguara bruto gjatë kësaj periudhe arritën në 1,377 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej 8.5%, kryesisht për shkak të sigurimit motorik, që përbën pjesën më të madhe të dëmeve.

GRAFIK: PRIMET E SHKRUARA BRUTO, SIPAS LLOJIT TË SIGURIMIT



TREGU I KAPITALEVE 2025

11 SHOQËRI
KOMISIONERE /
BANKA

9
2
1

Banka që ofrojnë shërbimin e kujdestarise

Banka që ofrojnë shërbimin e nënshkrimit të instrumenteve financiare

Banke që ofron shërbimin e administrimit të portofolit dhe këshillimit në investime

VLERA TOTALE E TRANSAKSIONEVE NË TITUJ



TREGU I TITUJVE TË QEVERISË JASHTË BURSËS PËR VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, transaksionet "Marrje dhe Transmetim urdhri në tregun primar (Ankand)" dhe "Shlyerje e vlerës nominale në maturim" udhëhoqën tregun e Titujve të Qeverisë jashtë Bursës.

Në tregun sekondar, vëllimi i transaksioneve paraqiti një balancë të qëndrueshme midis instrumenteve afatgjata (Obligacione) dhe atyre afatshkurtra (Bono Thesari), ndërsa këto të fundit mbizotëruan ndjeshëm për nga numri i transaksioneve.

Investitorët individualë mbajtën rolin kryesor në tregun sekondar, duke përqendruar shumicën e transaksioneve në bono thesari. Nga ana tjetër, aktiviteti në tregun sekondar (transaksionet B, C dhe F) shënoi rënie krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar një turrje të këtij segmenti.

ZHVILLIME NDËRKOMBËTARE

EIOPA 2030 – Një Vizion me Fokus Qëndrueshmërinë dhe Digjitalizimin

Strategjia e EIOPA deri në vitin 2030, vë theksin në forcimin e qëndrueshmërisë financiare dhe mbrojtjen e konsumatorit në një mjedis me paqëndrueshmëri të lartë gjeopolitike dhe mjedisore. Në themel të kësaj strategjie qëndron transformimi digjital, ku EIOPA synon të optimizojë administrimin e të dhënave, duke mbështetur detektimin, monitorimin dhe vendimmarrjen e informuar, si dhe duke mundësuar një bashkëveprim efektiv ndërmjet kontrollit njerëzor dhe inteligjencës artificiale. Një tjetër objektivi strategjik lidhet me promovimin e qëndrueshmërisë (ESG), përmes forcimit të raportimit, rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të gatishmërisë ndaj rreziqeve klimatike. Për më tepër, strategjia rikonfirmon parimin e proporcionalitetit si një instrument kyç për balancimin e efikasitetit rregullator me barrën administrative, duke siguruar që tregu i sigurimeve dhe pensione të mbetet i qëndrueshëm. Duke nxitur konvergjencën e praktikave mbikëqyrëse dhe duke mbajtur mbrojtjen e konsumatorit në zemër të strategjisë së saj, EIOPA synon të luajë një rol kyç në ndërtimin e një Europe më të qëndrueshme dhe një të ardhmeje më të sigurt, përmes një qasjeje proaktive dhe të orientuar drejt inovacionit.

> Lexo më shumë...

Evucioni i Solvency II: Kapitali, Qëndrueshmëria dhe Proporcionaliteti

Direktiva Solvency II ka qenë dhe vijon të jetë subjekt i amendimeve, ku ndryshimet më të fundit kanë prekur aktet e deleguara dhe standardet teknike zbatuese (ITS). Në fokus mbetet qëndrueshmëria mjedisore, rikalibrimi i kërkesave kapitale dhe parimi i proporcionalitetit. Një ndër objektivat e rishikimit lidhet drejtpërdrejt me incentivizimin e siguruesve për të alokuar kapital në strategji afatgjata, si Marrëveshja e Gjelbër (Green Deal) dhe Unioni i Tregjeve të Kapitalit (CMU).

Në këtë kuadër, amendimet e fundit sjellin implikime kritike në kërkesat rregullatore kapitale (Pillar I), duke ulur barrën e tepërt mbi siguruesit me profil rreziku të ulët. Një evolucion i rëndësishëm prek Raportin mbi Vetëvlerësimin e Riskut dhe Solvencës (ORSA), i cili tashmë pritet të integrojë analizën e skenarëve klimatikë afatgjatë. Së fundmi, për të optimizuar mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, EIOPA ka zyrtarizuar lehtësimin e barrës raportuese (Pillar III). Ndërsa targeti i përgjithshëm i reduktimit është 25%, për kategorinë e re të Shoqërive të Vogla dhe Jo-Komplekse (SNCUs), ky lehtësim arrin deri në 44% për raportimet vjetore, duke lejuar autoritetet mbikëqyrëse të fokusojnë burimet te subjektet me rëndësi sistemike.

> Lexo më shumë...

Inteligjenca Artificiale në Sigurime: Drejt një Epoke të Re të Mbikëqyrjes

Tregu evropian i sigurimeve po dëshmon një tranzicion të shpejtë nga modelet tradicionale të AI drejt Inteligjencës Artificiale Gjenerative (GenAI). Ndërsa modelet tradicionale të inteligjencës artificiale kanë tashmë vite që përdoren gjerësisht nga siguruesit - rreth 50% në segmentin Jo-Jetë dhe 24% në atë të Jetës (EIOPA, Raporti i Digjitalizimit 2024) - vlerësimet më të fundit tregojnë se një numër në rritje shoqërisht janë aktualisht në proces implementimi të GenAI. Ky hap nuk përfaqëson thjesht eficiencë të shtuar, por një ndryshim paradigme: GenAI po kalon nga funksionet mbështetëse drejt ndërveprimit të drejtpërdrejtë me klientët (përmes chatbot-it). Mesazhi i EIOPA është i qartë: inovacioni duhet të shoqërohet me kontroll të rreptë njerëzor për të garantuar mbrojtjen e konsumatorit dhe integritetin financiar në epokën e automatizimit inteligjent.

> Lexo më shumë...

¹ Insurance Recovery and Resolution Directive (IRRD)